



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenet 14 dhe 61 paragrafët 1.7 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Bashkim Ibrahim, zyrtar i prokurimit në Komunën e Podujevës **autorizohet** për kryerjen punëve dhe detyrave si dhe nënshkrimin e dokumentacionit nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të Prokurimit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së cekur për shkak të mungesës së Menaxherit të Prokurimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur komform rregullativës ligjore në fuqi, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Administratës - DA dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:
1. Autorizuarit
DA dhe Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr. prot. 02-370/01-0000272/25
Podujevë, datë: 03-01-2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 17 dhe 30.2 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neneve 16, dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të komunës së Podujevës nr.pro.01-020/01-0050862/18 të datës 29.06.208, merr;

VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR SINJALIZIM

Neni 1

Zyrtar përgjegjës për sinjalizim në kuadër të Komunës së Podujevës, caktohet:

znj. Jehona Ajvazi, zyrtare e gjendjes civile 4, në kuadër të Drejtorisë së Administratës

E-mail: jehona.ajvazi@rks-gov.net

Voip: 038 200 41- 085

Tel mob. +38343792772

Neni 2

Zyrtarja përgjegjëse detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe akteve tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore që i referohen fushëveprimt nga funksioni që ushtron.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr.pro. 02-020/05-0004187/2024, datë 15 janar 2024.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:

Të caktuarës

Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Zyrës së Personelit

QSHQ / Arkivës

Nr.Prot. 02-020/04-000118/25
Podujevë, datë: 08.01.2025



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe nenet 14 dhe 19 parag.1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT LOKAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

Neni 1

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale dhe të mirat tjera si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në territorin e Komunës së Podujevës, themelohet komisioni, në këtë përbërje;

Afrim Mulliqi,	kryesues
Vahide Veseli,	anëtare
Blerina Zeka,	anëtare
Alban Shabani,	anëtar
Albert Ajvazi,	anëtar

Neni 2

Komisioni punët dhe detyrat i ushtron në përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe aktet tjera përkatëse nënligjore në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot. 02-020/04-0011455/24, datë 15.02.2024, për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

U dërgohet;
Anëtarëve të komisionit
QSHQ/Arkivës

Nr. prot. 02-020/04-0011455
Podujevë, datë: 08-01-2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24 të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0000648/25, të datës 06.01.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. [redacted] nga fshati Llugë, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

QSHQ/Arkivit.

znj. [redacted] (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/03-0002200/25
Podujevë, datë, 10.01.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NËNKRYETARJA E KOMUNËS

Bazuar në nenet 5 dhe 8 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, nxjerr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E ASISTENTES ADMINISTRATIV NË ZYRËN E NËNKRYETARES SË KOMUNËS

Neni 1

znj. Veronë Pollomi, nga fshati Bajqinë Komuna e Podujevës, me kualifikim batchelor-drejtimi Administratë Publike, emërohet;

➤ **Asistente administrative në Zyrën e Nënkyetares së Komunës së Podujevës**

Neni 2

E përmendura në funksionin e cekur emërohet me qëllim të ofrimit të mbështetjes administrative teknike të Nënkyetares së Komunës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisive.

Mandati i të emëruarës është në kohëzgjatje të mandatit të Nënkyetarës së Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

Neni 3

Paga mujore e të emëruarës caktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Zyra e Personelit.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-101/03-0002470/25
Podujevë, datë: 13.01.2025



Nënkyetarja e Komunës
Marigona Lahu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E DREJTORIT/ESHËS TË DREJTORISË SË** **ADMINISTRATËS**

Neni 1

znj.Valbona Ibishi Azemi , me kualifikim juriste & MSC Gjuhë Angleze, nga fshati Orllan-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës**

Neni 2

E përmendura në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse Kryetari i Komunës me vendim të veçantë vendos ndryshe.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-101/03-0002692/25
Podujevë, datë: 13.01.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29.06.2018, jep këtë:

AUTORIZIM

Znj.Valbona Ibishi Azemi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës autorizohet të deponojë nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, për vulosjen e dokumentacionit që ka të bëjë me kompetencat dhe fushë veprimtarinë e Drejtorisë së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarës _____

U dërgohet:

*Të autorizuarës
Zyrës së Personelit
QSHQ/arkivit*

Nr. prot. 02-06/01-0002695/25
Podujevë, datë, 13.01.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-052/09-0002754/25, datë 13.01.2025, nxjerrë këtë;

VENDIM PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT / ESHËS TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU “HAMIT SEJDIU” NË FSHATIN KËRPIMEH KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

znj. **Fatmire Latifi**, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted], nga Podujeva, e kualifikuar Bachelor-Gjuhë dhe Letërsi Angleze,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtoreshës në SHFMU “Hamit Sejdiu” në fshatin Kërpimeh, Komuna e Podujevës.

Neni 2

E përmendura sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarës
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-101/03-0002866/25
Podujevë, datë: 14.01.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24 të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0002447/25, të datës 13.01.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

[redacted] i nga fshati Llapashticë e Poshtme Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor për djalin e tij [redacted] i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.
QSHQ/Arkivit.

[redacted] (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/03-0003217/25
Podujevë, datë, 15.09.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 42.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Transparencë të Hapur në Komuna dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Grupi punues për hartimin e draft Rregullores për Transparencë dhe draft Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Podujevës 2025-2028, në këtë përbërje:

Nexhat Tovërlani, *udhëheqës për komunikim me publikun- kryesues*
Marigona Lahu, *nënkryetare e Komunës, anëtare*
Fatlum Osmani, *drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-anëtar*
Adelina Stublla, *drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtare*
Ejup Babatinca, *udhëheqës i sektorit për zhvillim ekonomik-anëtar*
Fitim Bunjaku, *menaxher i personelit, anëtar*
Liridona Rrahmani, *zyrtare e lartë për komunikim me publikun-anëtare*
Sabedin Namani, *udhëheqës i zyrës ligjore(zyrtar për qasje në dokumente publike)-anëtar*
Xhyfidane Nimane, *zyrtare e IT-anëtare*
Hamide Jashari, *zyrtare e prokurimit-anëtare*
Genc Rashiti, *shoqëria civile- anëtar*

Neni 2

Grupi punues do të hartojë draftin e Rregullores dhe draft Planin e Veprimit për Transparencë në përputhje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi, përfshirë dërgimin e tyre në konsultim publik, si dhe do të ndjek të gjitha procedurat tjera përkatëse deri në miratimin e tyre.


Neni 3

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-020/05-0023985/25
Podujevë, datë: 17.01.2025



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

Enver Cakiçi, zyrtar për regjistrimin e kontesteve juridike në Drejtorinë e Administratës autorizohet edhe për kryerjen punëve nga fusha e arkivës në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të fushës së arkivimit të dokumentacione dhe materialeve në kuadër të administratës komunale, konform rregullativës ligjore në fuqi, me theks Ligjin Nr. 08/L-111 për Arkivat.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Personelit.

Neni 4

Autorizimi sipas këtij vendimi jepet për kohë të pacaktuar, përveç nëse nuk vendoset ndryshe me ndonjë akt tjetër.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

*1 Autorizuari
Drejtoria e Administratës
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva*

Nr. prot. 02-016/01-0004893/25
Podujevë, datë: 29.01.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11,13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 6 paragrafi 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 7 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 10 të Rregullores komunale nr. prot. 01-462/01-0062841/22 datë 29.07.2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një(1) vit të pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 14, 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, nxjerr;

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim më pak se një (1) vit, si vijon:

Ardiana Dibrani, udhëheqëse e sektorit për çështje pronësore juridike në DPKGJ
Kujtim Zhitia, zyrtar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Fidan Salihu, zyrtar në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Rilind Babatinca, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave
Mahmut Ajvazi, zyrtar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Kryesues i Komisionit do të jetë zyrtari nga Drejtoria të cilës i është drejtuar kërkesa për marrje në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi vepron në përputhje me rregullativën përkatëse ligjore në fuqi, me theks Rregulloren komunale për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës, ndër të tjera duke bërë shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen e kërkesave për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, përgatitjen e raportit përfundimtar, përfshirë edhe rekomandimin për palën e përzgjedhur/përfituese së bashku me Kontratën e cila nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i pronës.

Neni 3

Mandati i komisionit është dy (2) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr. prot. 02-020/04-0017971/24 datë 14.03.2022.

U dërgohet;
Drejtorive përkatëse dhe anëtarëve të komisionit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/05000639/25
Podujevë, datë: 29.07.2025



Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 15 paragrafi 1 nën paragrafi 6 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24 të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 05-400/04-0001897/25, të datës 09.01.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Gentiana Statovci Bejta, nga Podujeva, për pjesëmarrje të vajzës së saj Liana Bejta në garat ndërkombëtare “Hi Lingua” në Paris të Francës i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat barten në llogarinë bankare të znj.Gentiana Statovci Bejta, e cila ka për obligim që pas përfundimit të garave që mbahen në Paris të Francës të ofroj dëshmi për vajzën e saj lidhur me pjesëmarrjen dhe sukseset e regjistruara në këtë garë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Arsimit - DKA.

QSHQ/Arkivit.

znj.Gentiana Statovci Bejta (njoftohet përmes DKA-së)

Nr.prot 02-400/01-0006763/25
Podujevë, datë, 30.01.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 15 paragrafi 1 nën paragrafi 6 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24 të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0004506/25, të datës 21.01.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Marigona Gashi Abdullahu, nga fshati Llaushë Komuna e Podujevës për pjesëmarrje të djalit të saj Amar Abdullahu në garat ndërkombëtare “Hi Lingua” në Paris të Francës i jepet ndihmë financiare në shumë 400.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat barten në llogarinë bankare të znj.Marigona Gashi Abdullahu, e cila ka për obligim që pas përfundimit të garave që mbahen në Paris të Francës të ofroj dëshmi për djalin e saj lidhur me pjesëmarrjen dhe sukseset e treguara në këtë garë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Arsimit-DKA.

QSHQ/Arkivit.

Znj.Marigona Gashi Abdullahu (njoftohet përmes DKA-së).

Nr.prot 02-400/01-0006761/25
Podujevë, datë, 30.01.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 15 paragrafi 1 nën paragrafi 6 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0063865/24 të datës 20.09.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0004505/25, të datës 21.01.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Hazbije Aliu nga Podujeva për pjesëmarrje të djalit të saj Etrit Aliu në garat ndërkombëtare “Hi Lingua” në Paris të Francës i jepet ndihmë financiare në shumë 300.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat barten në llogarinë bankare të znj.Hazbije Aliu e cila ka për obligim që pas përfundimit të garave që mbahen në Paris të Francës të ofroj dëshmi për djalin e saj lidhur me pjesëmarrjen dhe sukseset e reguara në këtë garë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Arsimit – DKA.

QSHQ/Arkivit.

znj.Hazbije Aliu (njoftohet përmes DKA-së).

Nr.prot 02-400/01-0006757/25
Podujevë, datë, 30.01.2025

